




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY



DATË/A:	16/08/2017
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Ejup KASTRATI Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Kamenicës
CC:	z. Begzad SINANI Kryetar në Komunën e Kamenicës
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Asfaltimi i Rrugës Kopernicë Pusi i Zenelit- SHFMU"

I nderuari z. Kastrati,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " Asfaltimi i Rrugës Kopernicë Pusi i Zenelit- SHFMU" me numër prokurimi: KM653 17 2716 521, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Asfaltimi i shtatë rrugëve lokale (projekt dy vjeçar)" me numër prokurimi: KM653 17 2716 521, në mënyrë që të

respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

A r s y e t i m i

Agjencia Kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare përmes kërkesës të datës 06/07/2017 me numër protokolli 03-03/1620/17 iu është drejtuar Autoritetit Kontraktues Komuna e Kamenicës, duke kërkuar tërë dokumentacionin në lidhje me aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i Rrugës Kopernicë Pusi i Zenelit – SHFMU” me numër të prokurimit: KM653 17 2631 521.

Dokumentacioni i kërkuar është ofruar ne Agjenci për trajtim me datën 02.08.2017 nga Autoriteti Kontraktues dhe Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka trajtuar dhe analizuar me kujdes tërë dokumentacionin në dispozicion për këtë aktivitet të prokurimit ka konstatuar faktet si në vijim:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Kamenicës më datë 09.06.2017 ka publikuar ne web faqen e KRPP-së njoftimin për kontratë me titull” Asfaltimi i rrugës Kopernice Pusi i Zenelit- SHFMU” në procedurë të hapur, kontratë për punë me vlerë të mesme.

Më datë 12.06.2017 Autoriteti Kontraktues Komuna e Kamenicës ka publikuar ne web faqen e KRPP-së njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: Asfaltimi i rrugës pusi i Zenelit – SHFMU me arsyetimin si në vijim: *Ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është i nevojshëm për shkak të ngjarjeve dhe/apo arsyeve objektive dhe të demonstrueshme të cilat janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe të cilat kanë qenë të paparashikueshme në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit.*

Ndërsa me datë 15.06.2017 Autoriteti Kontraktues publikon në KRPP përsëri aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rrugës Kopernicë Pusi i Zenelit-SHFMU në Ri-tender. Sipas njoftimit në fjalë afati i fundit për pranimin e tenderëve është deri më datë 11.07.2017, po ne këtë datë është paraparë të bëhet edhe hapja e ofertave në orën 14:00.

Sipas procesverbalit të hapjes së tenderëve të datës 11.07.2017, dosjet e tyre i kanë dorëzuar gjithsej tre operatorë ekonomikë, gjatë procesit të hapjes nuk është evidentuar ndonjë vërejtje nga ana e anëtarëve të komisionit për hapje të ofertave.

Sipas evidencave të procesverbalit për hapje të ofertave OE i cili ka ofertuar me çmimin më të lirë në mesin e OE konkurrues ka qenë OE Company Zuka Commerce- me çmim prej 288,310.21€, i cili OE edhe është rekomanduar për dhënje të kontratës nga ana e komisionit vlerësues.

Bazuar në raportin e vlerësimit të tenderëve i përgatitur me datë 17.07.2017 të tre Operatorët konkurrues kanë plotësuar kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara nga ana e Autoritetit Kontraktues, mirëpo gjatë vlerësimit të ofertave financiare OE “EL- BAU” SH.P.K në përshkrimin e çmimeve nuk ka dhënë çmim për njësi në Pikën 2 tek punët e betonit njësi V.14, e me kete rast nuk mund të përmirësohet oferta e tij dhe nuk mund të vazhdojmë tutje, prandaj komisioni vlerësues e ka shpallur si te papërgjegjshëm këtë operator.

Gjatë trajtimit të dokumentacionit në fjalë Agjencia ka vërejtur se te raporti i vlerësimit të tenderëve, tek rubrika Lista e plote standarde për përshtatshmërinë profesionale te tenderëve , është potencuar se te gjithë operatorët konkurrues janë ne pajtim me këto kërkesa dh.m.th, i plotësojnë te gjitha kërkesat e përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktues, e që u mundëson operatoreve konkurrues vazhdimin e vlerësimit te mëtutjeshëm.

Mirëpo gjatë trajtimit të dokumentacionit ne lidhje me kete aktivitet te prokurimit Agjencia ka konstatuar se jo të gjithë OE konkurrues janë te përgjegjshëm ne lidhje me kërkesat qe kane te bëjnë me përshtatshmërinë profesionale konkretisht me Certifikatat ISO të kërkuara për këtë tender.

Operatori Ekonomik i cili edhe është rekomanduar për dhënie te kontratës “Company Zuka Commerce” nuk i posedon Certifikatat: Certifikatën për menaxhim të cilësisë ISO 9001-2008 si dhe Certifikatën për cilësi të asfaltit dhe betonit OHSA 18001-2007. Mirëpo Operatori në fjalë ka lidhur një marrëveshje me OE Tali sh.p.k. me tekstin si në vijim:

Kompanitë “Tali” sh.p.k. dhe “Company Zuka Commerce” sh.p.k. kanë arritur marrëveshje për posedimin e çertifikateve ISO 39001:2012 dhe ISO 9001:2008 të nevojshëm nga ana e Furnitorit “TALI” sh.p.k. për nevoja të “Company Zuka Commerce” sh.p.k. Kjo marrëveshje është valide për periudhën 10.07.2017 deri më 10.07.2018 dhe si e tillë mund të shkëputet vetëm me pëlqimin e të dyja palëve.

Si përfundim OE i rekomanduar për dhënie të kontratës “Company Zuka Commerce” sh.p.k. në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka hyre si konzorcium me ndonjë OE, mirëpo ka bërë vetëm një marrëveshje interne me OE Tali sh.p.k për posedim të certifikatave ISO të cekura si më lartë.

Operatori Ekonomik Papenburg + Adriani Company- ne dosjen e tij ka ofruar Certifikatën për menaxhim të cilësisë ISO 9001: 2008 dhe Certifikatën për cilësi të asfaltit dhe betonit OHSAS 18001:2007.

Sa i përket konzorciumit EL-Bau & EING-COM, OE El BAU nuk i posedon asnjërën nga certifikatat për ISO standarde të kërkuara nga ana e Autoritetit Kontraktues.

Sipas Nenit 69- Aftësitë Teknike dhe/ose profesionale të LPP-së, Autoritet Kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkesë, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në këtë nen. *Paragrafi 2.5 certifikatave të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë ose agjencitë kompetente të pranuar që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve, që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse.*

Ne neni 71 të LPP dhe në nenin 27- të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik konkretisht paragrafi 27.3 thuhet që secili anëtarë i grupit duhet të përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, neni 65 i LPP-së, ndërsa çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të LPP-së do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.

Agjencia gjatë vlerësimit ekzaminimit dhe krahasimit të dokumentacionit për tenderin “Asfaltimi i shtatë rrugëve lokale (projekt dy vjeçar)” ju njofton me të gjeturat e këtij aktiviteti të prokurimit dhe rekomandon AK që të veproj komfor LPP për situatat e tilla duke marr parasysh që të gjeturat ua dërgojmë në shqyrtim dhe vendosje. Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

